



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli:	Zyrtar/e i/e lartë për stabilitet financiar
Grada:	P05
Kohëzgjatja e punësimit:	me afat të pacaktuar
Departamenti:	Departamenti i Stabilitetit Financiar, Hulumtimeve dhe Analizave Ekonomike
Divizioni:	Divizioni i Stabilitetit Financiar
I raporton:	Udhëheqësit të Divizionit të Stabilitetit Financiar

Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësi:

- Përpunon dhe analizon të dhëna duke përdorur metoda dhe mjete të avancuara statistikore për të identifikuar trende dhe rreziqe që mund të ndikojnë në stabilitetin financiar, duke siguruar saktësinë, qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e tyre për marrjen e vendimeve;
- Menaxhon dhe administron kornizat e brendshme të vlerësimit të rreziqeve sistemike, përfshirë kornizën e stres-testit makroprudencial;
- Hulumton dhe propozon mjete, korniza dhe mekanizma për analizimin e të dhënave dhe vlerësimin e rreziqeve financiare, si dhe kontribuon në përcaktimin e kërkesave për të dhënat e nevojshme, përfshirë mbledhjen, përpunimin dhe organizimin e tyre për proceset e hulumtimit;
- Rekomandon dhe kontribuon në çështje të ndryshme me relevancë për fushën e stabilitetit financiar dhe proceset e punës në departament;
- Mbështetë bashkëpunimin e nevojshëm me të gjitha palët relevante përkitazi me çështjet e stabilitetit financiar, përfshirë dhe Komitetin Këshillëdhënës të Makroprudencës;
- Përbush detyra tjera në bazë të kërkesës së mbikëqyrësit.

Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:

- Të ketë të kryer fakultetin e ekonomisë dhe financave, matematikës financiare, shkencave kompjuterike ose shkencën e të dhënave (data science); preferohet diploma Master;

- Të ketë përvojë pune prej së paku 3 vite në sistemin financiar, në fushat relevante të menaxhimit të rrezikut, menaxhimit të sistemeve të informacionit (MIS) dhe të ngjashme; Përvoja më e gjatë në fushën relevante përbën avantazh;
- Kërkohen aftësi të shquara analitike dhe interpretim/analizim të të dhënave;
- Kërkohet të demonstroj aftësi të shquara të komunikimit verbal dhe me shkrim, dhe prezantimit tek mbikëqyrësi dhe palët tjera;
- Aftësi për të punuar në mënyrë efektive në ekip; aftësi në menaxhimin e kohës lidhur me kompletimin dhe cilësinë e detyrave të punës; aftësi për të punuar në mënyrë efektive me mbikëqyrësin dhe ekipin; aftësi të punuarit, diskutimit dhe bindjes me palët e jashtme;
- Shkathtësi të avancuara statistikore/ekonometrike dhe njohuri të programeve për përpunimin dhe analizim të të dhënave;
- Aftësi të caktimit të prioriteteve të punës dhe të përmbushjes së afateve;
- Njohja e shkëlqyeshme e gjuhës angleze paraqet përparësi.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- **Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- **Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **02 maj 2025**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org